



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07 Dhjetor 2020

Nr: 27

**VENDIM**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË  
KANDIDATIT Z. FLORJAN FLAMUR DOGA NGA LISTA SHUMEMËRORE E  
PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, PËR KËSHILLIN E BASHKISË DIVJAKË,  
NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË  
PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE  
PUBLIKE”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

**VËREN**

Me shkresën nr. 1733 prot., datë 26.10.2020, këshilli i bashkisë Divjakë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të dorëheqjes nga mandati i këshilltarit z. Mina Trifon Biti, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Divjakë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 27, z. Florjan Flamur Doga.

Me shkresën nr. 1733/1 prot., datë 17.11.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Divjakë, z. Florjan Flamur Doga, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.



Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0053 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar z. Florjan Flamur Doga, në këshillin e bashkisë Divjakë, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2121 prot., datë 26.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2122 prot., datë 26.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Florjan Flamur Doga, në Këshillin e Bashkisë Divjakë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Divjakë, z. Florjan Flamur Doga.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 12131/1 prot., datë 01.12.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Florjan Flamur Doga, në këshillin e bashkisë Divjakë, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.





Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar paragrafi 2, Kreu V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar z. Florjan Flamur Doga, në këshillin e bashkisë Divjakë, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Divjakë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja "n" dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

#### **VENDOSA:**

1. Z. Florjan Flamur Doga, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Divjakë, i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Divjakë, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore z. Florjan Flamur Doga, i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

